



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 50

Prishtinë, më 26 shtator 2012, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Bahri Thaqi, Liburn Aliu, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa dhe Flora Brovina.

Mungoi: Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Aurora Bakalli, deputete, Shpresa Haxhijaj- Administratore e Komisionit dhe Enis Halimi – Zyrtar i fushës për shëndetësi.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 29.08.2012 dhe 04.09.2012;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Shëndetësi;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Odat e profesionistëve shëndetësorë, para miratimit në parim;**
- 5. Shqyrtimi i raportit të monitorimit të Ligjit të punës;**
- 6. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Me propozimin e kryesuesit, u hoq pika e pestë e rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 29.08.2012 dhe 04.09.2012

Komisioni miratoi procesverbalet e mbajtura më 29.08.2012 dhe 04.09.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Shëndetësi

Fikrim Damka- Tha se ne e kemi shqyrtuar Projektligjin e shëndetësisë dhe i kemi hasur disa pika diskutabile, për të cilat kemi kërkuar sqarime shtesë nga ministri. Ne do të ndalemi vetëm të amendamentet për të cilat duhet të ketë sqarime shtesë.

Ferid Agani- Duke i falënderuar anëtarët e Komisionit për ftesën, tha se sa i takon dallimit në mes të “emergjencës” dhe urgjencës”, nuk ka në gjuhën shqipe fjalë “emergjencë”. Megjithatë, ne e kemi sjellë shtjellimin e këtyre dy termave.

Sa i përket përfaqësuesit të fakultetit të mjekësisë në Bordin e SHKSK, ne këtë duhet t’ia lëmë fakultetit në kompetencë se kë e delegon për ta përfaqësuar atë në këtë bord. Çështja e pagës së punëtorëve shëndetësorë, të cilët janë mësimdhënës në fakultet, duhet të definohet më mirë. Në kontratat e tyre duhet të specifikohet që ata duhet të punojnë me orar të plotë të punës, ndonëse nuk mund t’i marrin dy rroga të plota nga i njëjti buxhet. Duhet të gjejmë një zgjidhje edhe me universitetin.

Time Kadriaj- Tha se duhet të definohet më mirë orari i punës së këtyre punëtorëve të cilët janë të angazhuar edhe në mësimdhënie.

Flora Brovina- Tha se duhet të bëhet një marrëveshje me qëllim të gjetjes së zgjidhjes për këtë çështje.

Salihe Mustafa- Tha se duhet të gjendet një zgjidhje e mirë për këtë çështje.

Bahri Thaqi- Tha se në Projektligj kjo çështje është e rregulluar mirë.

Fikrim Damka- Tha se për nenin 41 i kemi disa propozim-amendamente.

Ferid Agani- Tha se këto propozime nuk janë të qëndrueshme dhe me reformën duhet të fillojmë menjëherë. Pra, nuk duhet të kemi kushtëzime të këtij lloji. Ne nuk duhet të humbim kohë dhe duhet të futemi në reformë dhe nuk kemi arsye që ta shtyjme zbatimin e këtij neni. Duhet që punëtorët shëndetësorë të përcaktohen se në cilin sektor duan të punojnë. Ne kemi siguruar një fond për stimulimin e punëtorëve shëndetësorë. Ata që hezitojnë të përcaktohen, janë të prirur për manipulime në sektorin publik.

Salihe Mustafa- Tha se ka një rrezik për të aplikuar menjëherë këtë nen. Duhet një kohë për ta pasur një qartësi më të madhe për parë funksionimin e këtij ligji. A është në gjendje Ministria ta përballojë këtë gjendje që do të krijohet me një ndarje të tillë.

Liburn Aliu- Tha se jam skeptik për këtë nen. Por, ky nen është thelbi i kësaj reforme. Nëse këtë e heqim, atëherë po përgatitemi për dështim që në start. Kjo është e guximshme dhe kjo do ta përcaktojë suksesin e kësaj reforme.

Flora Brovina- Tha se duhet të futemi në këtë rrugë dhe nuk do të duhet të kemi dilema, pra duhet të bëjmë hap të guximshëm.

Nazane Breca- Tha se së shpejti do të miratohet edhe Ligji për sigurime dhe nuk do të ketë dallim se në cilin sektor do të punohet, në atë publik ose në atë privat.

Aurora Bakalli- Tha se derisa nuk ka ligj për sigurime, sektorët publik dhe privat nuk janë të barabartë.

Bahri Thaçi- Tha se ky hap nuk është pa rrezik. A mundemi ne t'u sigurojmë punëtorëve shëndetësorë një trajtim më të mirë financiar? Çështja e punës së mjekëve në praktikën private në institucione publike është një gjë shumë e mirë, por vetëm duhet të shikohet mënyra e realizimit të saj.

Time Kadriaj- Tha se kjo ndarje e sektorëve do të paraqet problem, sidomos në profilet deficitare. Problemi është te menagjerët e institucioneve shëndetësore, të cilët nuk e kryejnë punën si duhet. Unë jam për punësimin e të gjithë mjekëve, por kjo duhet të rregullohet me një vendim tjetër dhe jo kjo të rregullohet me këtë ligj.

Gëzim Kelmendi- Tha se këto dilema janë vetëm për një pakicë të mjekëve, ndërsa shumica e mjekëve varen nga paga që e marrin në sektorin publik. Do të ketë lirim të vendeve të punës nga ato kuadro që do të dalin të punojnë në sektorin privat.

Ferid Agani – Tha se esenca e gjithë reformës është krijimi i Shërbimit Spitalor Klinik të Kosovës. Në ligj është përcaktuar mënyra e funksionimit të këtij trupi. Ky institucion do të jetë blerës i shërbimeve nga Agjencioni i Financimit të shëndetësisë, por edhe nga institucione të tjera. Mundësia e bankrotimit të këtij institucioni është shumë e vogël, ndërkaq mundësia e zhvillimit të institucioneve shëndetësore është shumë e madhe. Ministrisë i mbetet vetëm mbikëqyrja e zbatimit të ligjit. Pra, me këtë sistem mundësohet një decentralizim në sistemin shëndetësor. E vetma mënyrë për t'i siguruar pagat për punëtorët e rinj shëndetësorë është futja e këtij obligimi në ligj.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Odat e profesionistëve shëndetësorë, para miratimit në parim

Fikrim Damka- Pyeti anëtarët e Komisionit se a janë që Projektligji për Odat e profesionistëve shëndetësorë të shkojë në lexim të parë në seancën plenare?

Komisioni unanimisht vendosi për miratimin e Projektligjit për Odat e profesionistëve shëndetësorë, para miratimit në parim dhe përcjelljen e tij në seancë plenare.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka